



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:078950  
Datë: 22.01.2024  
Numri i dokumentit: 05222847

**Ka. nr. 6/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurës Subjektit Ekonomik – si person juridik “HIB Petroll”, SHPK, me Drejtorë Visar Bytyqi, me NRB: 810662834, me seli në magjistralen Prishtinë - Shkup - Prishtinë, për kundërvajtje nga neni 15 par. 3 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, sanksionuar me nenin 19 par. 13 pika 13.1 si dhe për kundërvajtje nga neni 9 par. 2 pika 1.2 lidhur me nenin 26 të sanksionuar me nenin 137 të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga e pandehura Subjekti Ekonomik – si Person juridik “HIB Petroll”, SHPK përmes avokatores Koci & Vokshi, sipas autorizimit avokatit Granit Vokshi, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.1627/2022, të datës 23.11.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe neni 78, konform të nenit 143 par. 1 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 19.01.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e paraqitur nga e pandehura Subjekti Ekonomik – si Person juridik “HIB Petroll”, SHPK, me Drejtorë Visar Bytyqi, me NRB: 810662834, me seli në magjistralen Prishtinë - Shkup - Prishtinë SHPK, përmes avokatores Koci & Vokshi, sipas autorizimit avokatit Granit Vokshi, ndërsa **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 1627/2022, i datës 23.11.2023, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e MINT-së - Inspektorati i Tregut me numër të protokollit 2434-19, të datës 15.04.2022, me Aktgjykim

K. nr. 1627/2022, të datës 23.11.2023, ( dhe sipas Aktvendimit të datës 24.11.2023 mbi Korrigjimin e Aktgjykimit 1627/2022, të datës 23.11.2023), të pandehurën subjektin ekonomik si person juridik "HIB Petroll", SHPK, me Drejtorë Visar Bytyqi, me NRB: 810662834, me seli në magjistralen Prishtinë - Shkup - Prishtinë, e ka shpall përgjegjëse sepse:

- me datën 30.03.2022 rreth orës 11:30, gjatë inspektimit nga Inspektorja Fexhrie Salihu, Inspektore e Tregut në MINT-së, në bashkëpunim me Inspektorët e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK-së), në bazë procesverbalit Nr. 00573/22, të datës 30.03.2022, është konstatuar se Subjekti Ekonomik "HIB Petroll" SH.P.K me numër NRB:810662834, me seli magjistralen PR-Shkup - Prishtinë, i cili merret me veprimtarin e shitjes me shumicë dhe pakicë të naftës dhe derivateve të naftës, lidhur me verifikimin e marzhës tregtare të derivateve të përcaktuar me Vendim Nr. 02/66, të datës 30.03.2022, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, bazuar në Procesverbalin Nr. 00573/22, të datës 30.03.2022, dhe Raportit të Inspektorëve të Administratës Tatimore (ATK-së,) të datës 15.04.2022, është konstatuar se e ka tejkaluar marzhën tregtare të përcaktuar me Vendim me Nr. 02/06 të datës 01.03.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për rregullimin e çmimeve të caktuara,-

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 15 par. 3 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, sanksionuar me nenin 19 par. 13 pika 13.1 si dhe për kundërvajtje nga neni 9 par. 2 pika 1.2 lidhur me nenin 26 të sanksionuar me nenin 137 të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, dhe me aplikim të nenit 35 par. 1, të Ligjit Për Kundërvajtje të Republikës së Kosovës, i është shqiptuar dënimi me **gjobë në shumën prej 4000(katërmijë)€**. Po ashtu është obliguar i pandehuri që gjobën e shqiptuar të paguan në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në xhirollogari të Këshillit Gjyqësor No.1000 4300 7000 0518, po ashtu i pandehuri obligohet që në afat të lartcekur të paguaj dhjetë **10(dhjetë)€**, në emër të paushallit gjyqësor, nëse i pandehuri nuk e bënë pagesën e gjobës në afatin e parapara me ligj pagesa do të bëhet sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë e Subjekti Ekonomik – si Person juridik "HIB Petroll", SHPK përmes avokatores Koci & Vokshi, sipas autorizimit avokatit Granit Vokshi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të Ligjit material, në të cilën veç të tjerash thekson se: gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitat ligjore të cilat kanë pas ndikim drejtpërdrejtë në nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë. Në rastin konkret gjykata ka aplikuar dispozitat e një ligji i cili tash më një kohë është ç fuqizuar pikërisht Ligji Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorëve me Ligjin Nr.06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, ndërkaq aktgjykimi është nxjerr më datë 23.11.2023, që i bie se kanë kaluar 5 nga hyrja në fuqi e ligjit të ri, çka përmban shkelje esenciale të procedurës kundërvajtëse e po ashtu është përfshirë me aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Aktgjykimi ka shkelje nga neni 139 par. 1 pika 1.9 të LK-së, pasi që dispozitivi është i pa kuptueshëm, kundërthënës me vetveten dhe arsyet e vendimit, dhe nuk përmban arsye të mjaftueshme me të cilat do të vërtetoheshin faktet vendimtare, andaj konsiderojnë se aktgjykimi i ankimuar është i kundërligjshëm.

Neni 87 i LK-së, thotë: 1. Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes paraqitet me shkrim dhe duhet të përmbajë: 1.1. të dhënat themelore për të pandehurin (emrin dhe mbiemrin, emrin dhe mbiemrin e njërit prind, vendlindjen dhe datëlindjen, vendbanimin dhe vendin e inkuadrimit në punë, rrugën e numrin dhe profesionin), respektivisht emrin dhe selinë e personit të pandehur juridik, kurse për personin përgjegjës në personin juridik edhe funksionin që e ushtron në atë person juridik; 1.2.

përshkrimin faktik të veprimeve nga të cilat rezultojnë tiparet juridike të kundërvajtjes, kohën dhe vendin e kundërvajtjes së kryer dhe rrethana të tjera të nevojshme që kundërvajtja të caktohet në mënyrë më të hollësishme; 1.3. kualifikimi juridik i kundërvajtjes; 1.4. propozimi për provat që duhet të administrohen.

Nga Kërkesa vërehet çart se nuk përmban asnjë nga elementet e përcaktuara me ligj. Po ashtu nuk përmban asnjë provë apo Propozim për administrimin e ndonjë prove e cila do të mbështete pretendimet e tilla andaj Kërkesa e tillë ashtë dashtë të hudhet poshtë, konform nenit 89 par. 1 të LK-së.

Po ashtu konsiderojnë se procedura kundërvajtëse është përfshirë me parashkrim sipas neni 42 par. 1 të LK-së. Po ashtu Procesverbali mbi inspektim i datës 30.03.2022 është tejet i mangët e po ashtu Vendimi Nr. Nr. 02/66, të datës 30.03.2022, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nuk afron pasqyrë të qartë se si bëhet vlerësimi i marzhës tregtare. Po ashtu edhe Vendimi mbi sanksionin kundërvajtës është nxjerr në mënyrë të kundërligjshme, duke mos i marr parsysh rrethanat lehtësuese.

I propozon Gjykatës se Apelit - Divizioni i Kundërvajtës, që ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e goditur ta Ndryshoj duke e liruar të pandehurën në mungesë të provave ose ta Anulon dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka paraqit Ushtruesi i Kërkesës MINT-së - Inspektorati i Tregut me numër të protokollit 26/19 të datës 05.01.2024, në ç rast ka kërkuar që ankesa e të pandehurit të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimin të vërtetohet.

Kolegji i Gjykatë së Apelit vlerësoj thëniet në ankesën e paraqitur, aktgjykimin e goditur, si dhe shkesat tjera të lëndës dhe konstatoj se ankesa e ushtruar është e pa bazuar dhe refuzohet aktgjykimin i goditur vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e zhvillimit të procedurës për veprën kundërvajtëse, në bazë të deklaratës së Përfaqësuesit Astrit Topalli i autorizuar nga aksionari Ibrahim Bucaliu, pasi që tani nuk është Drejtor Visar Bytyqi por Kujtim Bucaliu, të dhënë në seancën gjyqësore e shqyrtimit të mbajtur konform nenit 119 të LK-së, pranë gjykatës së shkallës së parë, në Procesverbal të datës 20.07.2023, në ç rast si Përfaqësues i së pandehurës ka deklaruar se e kundërshtojnë Kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, kërkon që gjykata ta hudhë kërkesën në ç rast Inspektorja e Tregut të MINT-së, Eljesa Beqiri, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesës pasi që në rastin konkret në bazë të Raportit të përpiluar të Inspektorëve të ATK-së, është vërtetuar se subjekti ekonomik e ka tejkaluar marzhën e përcaktuar sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës, në bazë të Procesverbalit 19/00573 i datës 30.03.2022 mbi inspektimin e bërë, Raporti i bërë nga ATK-a, të gjeturat gjatë verifikimit të çmimit të shitjes (marzha e fitimit) duke i krahasuar çmimet e blerjes me çmimet e shitjes me pakicë prej datës 12.03.2022, Vendimit Nr. 02/66 të datës 01.03.2022, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe nga shkresat tjera të lëndës, pa dyshim se gjykata e shkallës së parë, e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 15 të Ligjit Nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, sanksionuar me nenin 19 par. 13 pika 13.1 si dhe kundërvajtje nga neni 26 të Ligjit Nr. 06/L-034, sanksionuar me nenin 137 të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, për të cilën mban përgjegjësi kundërvajtëse, andaj në këtë drejtim nuk ka bazë për ndryshimin apo anulimin e aktgjykimin të goditur, ashtu si që pretendohet në ankesë.

Kolegji aktgjykimin e ankimuar e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe në këtë aspekt gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje nga neni 139 të LK-së, e të cilat detyrimisht do ta kishim kushtëzuar prishjen e aktgjykimin.



Sa i përket pretendimit ankimor se ka arritur parashkrimi relativ nuk qëndron pasi që gjykata e shkallë së parë ka nxjerr Aktvendim për fillimin e procedurës kundërvajtëse më datë 17.03.2023, i cili e ka ndërpre parashkrimin relativ sepse Neni 42 par. 1 i LK-së, **decidivisht thotë citim: “ Procedura e kundërvajtjes nuk mund të ndërmerret nëse kalon 1 vit nga data kur është kryer kundërvajtja, në paragrafin 3 të njëjtit nenë thuhet citim: “ Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të organit kompetent që ndërmerret për ndjekjen e kryesit të kundërvajtje”, në rastin konkret gjykata me aktvendim e ka ndërprerë parashkrimin relativ, që dmth se nuk ka kaluar një vjet.**

Kolegji, konstatoi se aktgjykimi i shkallës së parë është korrigjuar me **Aktvendimi të datës 24.11.2023** andaj i njëjti është i qartë, konkret, përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje kundërvajtëse dhe në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar e ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar si dhe ka dhënë arsyet e qarta për vërtetimin e tillë të fakteve, po ashtu Kolegji i kësaj gjykate i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të cekura në ankesë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi se janë të pa bazuara, të pa qëndrueshme si dhe pa ndikim sepse në shkresa të lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të cilave gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plot dhe të drejtë.

Kolegji i gjykatës së shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të butë ndaj të pandehurit.

Kolegji vlerësoj se gjykata e shkallës së parë, gjatë zbatimit të procedurës, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, përkatësisht aplikim të gabuar të së drejtës materiale, kurse gjoba e shqiptuar ndaj të pandehurit, në shumë prej 4000€, konsiderohet se është caktuar sipas shkallës së përgjegjësisë dhe është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës kundërvajtëse dhe shkallën e përgjegjësisë dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Konform të nenit 143 par.1 dhe par. 2 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Ka. nr. 6/2024, me datë 19.01.2024,**



**KRYETARJA E KOLEGJIT,**  
**Azra Cakolli**